



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 111/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Avni Klinaku kryetar i Lëvizjes për Bashkim, kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës në kuadër të listës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisioneve të QNR-s për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit në QNR, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Avni Klinakut, kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e LVV-së me seli në Prishtinë

Arsyetim

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga Avni Klinaku, me të cilën pretendohet se është dëmtuar rëndë në procesin e numërimit të votave në QNR. Sipas parashtruesit të ankesës, në bazë të informatave nga terreni dhe në bazë të krahasimit të rezultateve të KKZ-së dhe QNR-së, ka vërejtur se në 7 shtatë komuna është dëmtuar rend në rezultatin përfundimtar . në këto shtat komuna, për shkak të raporteve të brendshme me LVV ,Lëvizja për Bashkim nuk ka pasur komisionar dhe vëzhgues.

Sipas parashtruesit të ankesës, dëmtimi ju është bere në dy forma, në VV të shtatë komunave të kontestuara, ku në kutit e votimit rezultati ka qenë zero edhe në rastet kur në ato VV kanë votuar votues të tyre anëtar të Lëvizjes për Bashkim madje edhe anëtarët e këshillit të përgjithshëm të Lëvizjes për Bashkim, si dhe dëmtimi në QNR, ku sipas rezultatit të dal nga KKZ për Avni Klinakun ka siguruar një vend në kuvendin e ardhshëm të Kosovës. Mirëpo dëmtimi ka ndodhur gjatë procesit të numërimit në VV dhe ka vazhduar në QNR dhe sipas kësaj ju është pa mundësuar të jetë deputet në kuvendin e Kosovës. Në këtë përfundim ka ardhur si rezultat i analizës krahasuese midis rezultateve të KKZ dhe QNR. Në mungesë të Komisionerve dhe

vëzhguesve ne komunën e Gjakovës numri i votave te tij sipas KKZ ka qenë 250 ndërsa QNR ne vend se ta sanoj dëmtimin qe i u është bere nga VV, e dëmton serish duke ja llogaritur vetëm 156 vota (94 vota i dëmtuar).Situatë e ngjashme është edhe ne gjashtë komuna te tjera te kontestuara ku rezultati i dëmtimit shkon deri ne 361 vota te mjaftueshme për përmbysjen e rezultati.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që ne bazë te nenit 119.1 dhe 122.1 te LZP qe ne prani te një apo me shumë komisioneve dhe vëzhguesve te autorizuar nga ai te behet rinumërimi i votave te kandidateve te listës se LVV ne këto shtat komuna ku konsideron se manipulimi me vota eshte drastik .

Prishtinë , Gjakovë,Gjilan,Vushtrri,Fushë Kosovë,Viti dhe Kaçanik.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Për te vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesi i ankesës PZAP i beri një kërkesë KQZ-së më datë 31.01.2011, për sqarimin e pasqyrimit jo real të rezultateve përfundimtare dhe KQZ iu përgjigj kësaj kërkesë për sqarim me datë 01.02.2011,duke njoftuar se Procesin votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010/2011 e ka përshkruar një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës i kontrollimit, auditivit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave dhe rezultateve. Për shkak të mospërputhjeve të konstatuara numrit të fletëvotimeve mbi nivelin e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2011, 92 VV në zgjedhjet e 09 janarit 2011 dhe 38 VV në zgjedhjet e 23 janarit 2010.

Në rezultatet përfundimtare të QNR-së të shpallura nga KQZ-ja me 30 janar 2011 është përfshirë edhe numri i votave me kusht, votave të votimit përmes postës dhe atyre me nevoja te veçanta

Procesi i rinumërimit të votave në këto VV ka qenë transparent dhe është zhvilluar në praninë e vënguesve të subjekteve politike të certifikuara, medie, faktorit ndërkombëtar si dhe në bashkëpunim me këshilltarët e IFES-it.

Mbi bazën e gjithë këtij procesi janë prodhuar rezultatet e QNR-së të shpallura nga KQZ me 30 janar 2011.

PZAP shqyrtoi Listat e VV të rinumëruara sipas vendimeve përkatëse të KQZ-së dhe Master Lista me QV për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 dhe erdhi në përfundim se parregullsitë e pretenduara janë eliminuar gjatë rinumerimit dhe auditimit nga KQZ-ja. Si rrjedhim PZAP konstatoj se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë korrigjuar dhe për këtë arsye e refuzoi ankesën si të pabazuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 111/2011 më datën 02.02.2011.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

